## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE, VITI 2024

| Nr. Rendor | Data e regjistrimit të kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 01 | 04.01.2024 | Kërkesë për informacion gjeohapësinor, ortofoto. | 12.01.2024 | Territori në të cilin gjendet pasuria e përcaktuar në imazhet bashkëlidhur kërkesës tuaj, në zonën kadastrale nr. 8591, Shkodër, përfshihet në Ortofoto 2001, Ortofoto 2007 dhe Ortofoto 2015, të cilat j'ua kemi vënë në dispozicion zyrtarisht, me shkresën nr. 467/3 prot., datë 17.11.2023.<br><br>Ortofotot e pjesshme të viteve 1994 dhe 1999 nuk e përfshijnë territorin e përcaktuar në imazhet bashkëlidhur kërkesës tuaj.<br><br>Përsa i përket informacionit në imazhet e dërguara (shtresave të mbivendosura mbi shtresën bazë ortofoto, si parcelat, ndërtesat, rrugët, etj.) ai është informacion që krijohet dhe përditësohet nga autoritetet publike përgjegjëse respektive, të përcaktuara në metadatën e secilës shtresë, dhe vetëm mund të konsultohet në Gjeoportalin Kombëtar. | E pjesshme | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 02 | 26.01.2024 | Kërkesë për informacion gjeohapësinor, ortofoto. | 29.01.2024 | Ju bëjmë me dije se për territorin në të cilin gjenden pasuritë e cituara në kërkesën tuaj, në zonën kadastrale nr. 8595 Shkodër, për periudhën e kërkuar nga ju, zotërojmë Ortofoto 1999 (realizuar nga fotografimi ajror i pjesshëm i vitit 1999) dhe Ortofoto 2007 (realizuar nga fotografimi ajror 2007 -2008).<br><br>Bashkëlidhur po ju vëmë në dispozicion pamjet imazherike të printuara nga Gjeoportali Kombëtar, për territorin në të cilin gjenden pasuritë e cituara në kërkesën tuaj, në zonën kadastrale nr. 8595, Shkodër, si më poshtë:<br>• Ortofoto 1999 (data e fotografimit 02.11.1999);<br>• Ortofoto 2007 (data e fotografimit 25.06.2008). | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 03 | 26.01.2024 | Kërkesë për materiale hartografike. | 02.02.2024 | Ju bëjmë me dije se materialet hartografike të cilat kërkoni janë të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar dhe mund të aksesohen pa asnjë kufizim në link: https://geoportal.asig.gov.al/map/?auto=true Shërbimi i printimit në Gjeoportalin Kombëtar është gjithashtu i hapur për publikun. Instruksionet për përdorimin e këtij shërbimi mund ti gjeni në "Manual Përdoruesi mbi Gjeoportalit Kombëtar" në link: https://geoportal.asig.gov.al/sites/default/files/2017-08/ASIG_Geoportal-Manual_perdoruesi.pdf | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 04 | 21.02.2024 | Kërkesë për informacion gjeohapësinor, ortofoto. | 02.02.2024 | Në përgjigje të kërkesës datë 21.02.2024, protokolluar pranë Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) datë 21.02.2024, ju bëjmë me dije që përsa i përket rrugës dhe zonës ku ndodhet objekti i kërkesës tuaj, ASIG, në faqen e Gjeoportalit Kombëtar zotëron informacionin, si më poshtë:<br>• Fotografimi 2007 (data e fotografimit 07/07/2007);<br>• Fotografimi 2015 (data e fotografimit 29/05/2015);<br>• Fotografimi 2018 (data e fotografimit 27/05/2018).<br><br>Bashkëlidhur po ju vëmë në dispozicion pamjet imazherike të printuara nga Gjeoportali Kombëtar. | E plotë | Nuk ka |